



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1910/3.prot

Datë 01.11.2021

V E N D I M
K.P.P. 825 /2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-07016-10-01-2021, me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të administratës dhe mzsh-së*” me fond limit 1.786.939 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.10.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.

Ankimues: “Blueprint Technologies” SHPK
Adresa: Rruga “Fortuzi” 66/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lezhë
Adresa: Lagjja. “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.10.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-07016-10-01-2021, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të administratës dhe mzsh-së” me fond limit 1.786.939 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.10.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 11.10.2021 operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK ka paraqitur ankesë me nr. 1910 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Brenda afatit 5 ditor autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 17858/2 prot., datë 14.10.2021 protokolluar me tonën me nr.1910/2 prot., datë 18.10.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi Nr. 01, datë 14.10.2021 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, pranë Autoriteti Kontraktor, Bashkia Lezhë në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, e datës 14.06.2021 për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK dhe ka vendosur refuzim të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për Kriteret e veçanta të kualifikimit, Paragrafi 2.3, Kapaciteti teknik pika **2.3.2** *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë staf të kualifikuar dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën Qershor 2021-Gusht 2021, si më poshtë: 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet kompjuter që do të ofrohen nga OE*

- *1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router.*
- *1 (një) specialist të certifikuar për shërbime të IT (ITIL) ose ekuivalent*
- *Për të provuar disponimin e stafit të kërkuar, OE duhet të paraqesë:*
 - a. *Listëpagesat për periudhën Qershor 2021-Gusht 2021*
 - b. *Certifikatat përkatëse sipas kërkesave të mësipërme*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Operatori ekonomik kërkon: Heqjen e kërkesës për specialist IT (ITIL).

Zëvendësimin e kërkesës për specialist të certifikuar nga prodhuesi i Router dhe kompjuterëve me kërkesën për inxhinier të fushës Informatikë/elektronikë. Për instalimin e pajisjeve mjafton një specialist i fushës i diplomuar dhe nuk ka arsye të jetë i certifikuar nga prodhuesi. Në lidhje me kërkesën për specialist të certifikuar ITIL, vlerësojmë se nuk ka lidhje me këtë kontratë.

III.1.1 Autoriteti Kontraktor, në përgjigje të ankesës sqaron se: *Njësia e prokurimit, më datë 09.10.2021 ka ngarkuar në SPE shtojcën nr. 2. “Ndryshime në dokumentet e tenderit” dhe konkretisht pika 2.3.2.*

Ishte 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë staf të kualifikuar dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën Qershor 2021-Gusht 2021, si më poshtë:

- 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet kompjuter që do të ofrohen nga OE
- 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router.
- 1 (një) specialist të certifikuar për shërbime të IT (ITIL) ose ekuivalent
- Për të provuar disponimin e stafit të kërkuar, OE duhet të paraqesë:
 - c. Listëpagesat për periudhën Qershor 2021-Gusht 2021
 - d. Certifikatat përkatëse sipas kërkesave të mësipërme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Bëhet 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë staf të kualifikuar dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën Qershor 2021-Gusht 2021, si më poshtë:

- 1 (një) specialist të certifikuar për pajisjet kompjuter që do të ofrohen nga OE
- 1 (një) specialist të certifikuar për instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router.
- Për të provuar disponimin e stafit të kërkuar, OE duhet të paraqesë:
 - e. Listëpagesat për periudhën Qershor 2021-Gusht 2021
 - f. Certifikatat përkatëse sipas kërkesave të mësipërme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Autoriteti Kontraktor sqaron se: ndryshimet e kryera me shtojcën 2, të kryera nga njësia e prokurimit, përmbushin pikën e parë të ankesës së operatorit ekonomik. Si rrjedhojë kjo pikë e ankesës nuk qëndron.

III.1.2 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në pikën 1 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar ligjit vëren se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

K.P.P. gjykon se synimi bazë i autoritetit kontraktor në vendosjen e këtij kriteri është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e duhura për kryerjen e shërbimit të kërkuar dhe me cilësinë e kërkuar.

Kërkesa e operatorit ekonomik për këtë pikë nuk qëndron pasi ndryshimi është pasqyruar në shtojcë, publikuar përpara paraqitjes së ankesës. Operatori ekonomik nëse do të kishte pretendime në lidhje me shtojcën e ndryshimeve, duhej të kishte bërë ankim sipas parashikimeve të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për kriteret e veçanta të kualifikimit, Paragrafi 2.3, Kapaciteti teknik *pika 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë Konformiteti me standardet e komunitetit europian ose ekuivalente për pajisjet e ofruara.*

Operatori ekonomik kërkon: Reformulim të kërkesës: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Deklaratë Konformiteti CE nga prodhuesi”. Ankimesi sqaron se nuk ekziston Certifikatë Konformiteti me standardet e BE por deklaratë e Prodhuesit që pajisjet të jenë sipas CE. Markimi CE bëhet në paketimet e produkteve dhe në manualet shoqëruese.

III.2.1 Autoriteti Kontraktor, në përgjigje të ankesës sqaron se: Brenda kuadrit të Direktivave të BE-së prodhuesit janë përgjegjës për sigurim të konformitetit të produktit dhe marrjes së certifikatës së CE-së, por importuesit të duhet të sigurojnë që produktet që vendosen në treg të përputhen me kushtet e aplikueshme të në aspektin e sigurisë, shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit. Për këtë qëllim është kërkuar “Certifikatë Konformiteti me standardet e komunitetit europian ose ekuivalente për pajisjet e ofruara”.

III.2.2 Referuar Neni 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatorit ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.3 Referuar nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga

një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkon një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.4 Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, vëren se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se paraqitja e certifikatave të konformitetit, është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe duke qenë se, autoriteti kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që prokurohen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata për të vërtetuar konformitetin e prodhimit të produkteve. Certifikatat europiane të konformitetit tregojnë që produktet (mallrat) plotësojnë kërkesat ligjore të markave të komunitetit europian, mbajnë shenjën CE dhe përputhen me direktivat e BE-së, që janë prodhime të sigurta dhe nuk dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kërkesë për kualifikim “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë Konformiteti me standardet e komunitetit europian ose ekuivalente për pajisjet e ofruara*” duke vendosur termin “ekuivalent” nuk vendos kufizim por jep mundësi dhe alternativa të ngjashme që vërtetojnë sigurinë dhe cilësinë e mallit pa cenuar standardet, duke lënë

hapësirë operatorit ekonomik të paraqesë një dokument të barasvlefshëm me certifikatën e konformitetit në lidhje me standardet e kërkuara.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për kriteret e veçanta të kualifikimit, Paragrafi 2.3, Kapaciteti teknik pika **2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë aktin e marrëveshjes midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.**

Operatori ekonomik kërkon: Të hiqet kërkesa për akt-marrëveshjen midis prodhuesit dhe distributorit dhe të vërtetohet marrëdhënia midis prodhuesit dhe distributorit në forma të tjera. Kërkesën e justifikon me pretendimin se marrëveshjet mund të përmbajnë informacion konfidencial dhe ekonomik i cili nuk mund të ndahet me palët e treta.

III.3.1 Autoriteti Kontraktor, në përgjigje të ankesës sqaron se: *Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron pasi ligjvënësi ka parashikuar qartë hapat që ndiqen në rast kur dokumentacioni përmban informacion konfidencial. (neni 28 i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021.)*

III.3.2 Referuar nenit 16 “Konfidencialiteti” i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.
2. Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.
3. Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, dhe pa cënuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve sipas parashikimeve në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave.
5. Autoriteti ose enti kontraktor nuk do të bëjë publike informacionin konfidencial, të dhënë nga kandidati ose ofertuesi që merr pjesë në negociata ose dialog, në një procedurë konkurruese me

negocim, procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, dialog konkurrues ose partneritet për inovacion, pa dhënie e pëlqimit të këtij të fundit, me anë të një deklarate me shkrim. Kjo deklaratë nuk mund të përdoret si pengesë për aksesimin e të gjitha informacioneve, por duhet të lidhet vetëm me informacionin në fjalë.

6. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të ruajnë natyrën konfidenciale të informacionit që autoriteti ose enti kontraktor vë në dispozicion përgjatë procedurës së prokurimit.

III.3.3 Referuar nenit 28 “*Deklarimi i informacionit konfidencial*”, të VKM- së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”

1. Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin ose dokumentet që kërkon të mbahet konfidencial dhe argumentet për këtë. Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.

2. Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike, mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.

3. Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidencialenë përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. 3.4. KPP në lidhje me këtë pretendim arsyeton se: Ligji sqaron qartë cilat informacione mund të publikohen. Është e drejtë e operatorit ekonomik, që në përputhje me legjislacionin, të mos publikojnë apo dhe të mos verë në dispozicion dokumente që përmbajnë informacion konfidencial apo edhe dokumente sekrete, të cilat do të dëmtonin punën e kompanive prodhuese apo edhe distributorëve. Në dokumentet standarde të tenderit, **Shtojca 4.**(*Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti*) i jep mundësi operatorit ekonomik të listojë informacionin që dëshiron të mbetet konfidencial.

Gjithashtu edhe autoritetet apo entet kontraktore duhet ti përmbahen dispozitave ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit duke mos kërkuar nga operatorët informacione konfidenciale, apo të dhëna që përbëjnë sekrete teknike ose tregtare.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor, me kërkesën 2.3.2. [*...Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë aktin e marrëveshjes midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.] e ka tejkalluar objektin e prokurimit, pasi për autoritetin është e rëndësishme, që të sigurohet, që “malli ose shërbimi”, është sipas standardeve të kërkuara dhe specifikimeve teknike. Për sa më sipër në kuadër të mosdiskriminimit dhe krijimit të lehtësirave*

për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të mësipërcituar në lidhje me akt-marrvëshjen, duke parashikuar edhe forma apo dokumentacione alternative provuese të tjera, të cilat vërtetojnë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi duke përmbushur në këtë mënyrë edhe qëllimin e vendosjes së këtij kriteri.

Për sa më sipër autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse sipas arsytimeve të lartpërmendura.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për kriteret e veçanta të kualifikimit, Paragrafi 2.3, Kapaciteti teknik pika **2.3.6** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog me të dhënat teknike për artikujt që oferton. Në katalog të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të shënohen për të gjithë artikujt objekt-prokurimi.*

Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik kërkon: *Jemi dakord me kërkesën por do të luteshim të pranoheshin katalogët e origjinale në anglisht dhe jo përkthimi i tyre 99.9% të termave informatike janë në anglisht dhe përkthimi i katalogëve të kompjuterëve më shumë sjell angari, sesa i shërben procesit.*

III.4.1 Autoriteti Kontraktor, në përgjigje të ankesës sqaron se: *AKSHI publikon specifikimet teknike për pajisjet kompjuterike në gjuhën shqipe dhe si rrjedhojë katalogët duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar me qëllim krahasimi nga KVO.*

Bazuar në nenin 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” autoriteti kontraktor nuk e pranon pretendimin e ankimuesit.

III.4.2. Referuar Nenit 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos

jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

III.4.3. Referuar Nenit 24 pika 2 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-07016-10-01-2021, me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të administratës dhe mzsh-së*” me fond limit 1.786.939 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.10.2021 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro